

**VENDIM**  
**Nr. 768, datë 15.12.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA SPECIFIKE, LLOJEVE TË SHËRBIMEVE TË VEÇANTA, PËR TË CILAT MUND TË REZERVOHET E DREJTA E PJESËMARRJES SË ORGANIZATAVE NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK, SI DHE RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR PROKURIMIN E TYRE<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me Vendimin nr. 292, datë 15.4.2024)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 100, pika 2, e 103, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, sipas ndarjeve të mëposhtme, të detajuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi:

- a) shërbime rekreative, kulturore dhe sportive;
- b) shërbime të administrimit, të mbrojtjes dhe të sigurisë sociale;
- c) shërbime të hotelerisë dhe të restoranteve;
- ç) shërbime të edukimit e të trajnimit;
- d) shërbime të kujdesit shëndetësor e të kujdesit shoqëror;
- dh) shërbime personale, sociale dhe në komunitet.

2. Përcaktimin e llojeve të shërbimeve, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, sipas shtojcës 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Miratimin e rregullave të detajuara për prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dhe të miratojë dokumentet standarde për prokurimin e shërbimeve sociale dhe të shërbimeve të tjera specifike.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

---

<sup>1</sup> Ky vendim është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon direktivën 2014/18/KE”, të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 65–242;

- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga entitete që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE”, të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 94, datë 28.3.2014, faqe 243–374.

**RREGULLAT E DETAJUARA**  
**PËR PROKURIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA**  
**SPECIFIKE, SI DHE SHËRBIMEVE TË VEÇANTA, PËR TË CILAT MUND TË**  
**REZERVOHET E DREJTA E PJESËMARRJES SË ORGANIZATAVE NË**  
**PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK<sup>2</sup>**

Neni 1

**Dispozita të përgjithshme**

1. Autoritetet ose entet kontraktore, në kryerjen e procedurave për shpalljen e fituesve të kontratave për shërbimet, objekt i këtij vendimi, duhet të veprojnë në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe nxitjes së konkurrencës.

2. Autoritetet ose entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

3. Në përgatitjen e në kryerjen e procedurave të prokurimit për shërbimet objekt i këtij vendimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të garantojnë cilësi, vazhdimësi, aksesueshmëri, kosto-efektivitet, disponueshmëri dhe gjithëpërfshirje në shërbime.

4. Në hartimin e kërkesave për këto lloj shërbimesh, autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin në konsideratë, gjithashtu, nevojat specifike të kategorive të ndryshme të përdoruesve, duke përfshirë njerëzit në nevojë dhe grupet vulnerabël.

5. Përcaktimet e parashikuara në këtë vendim janë njësoj të zbatueshme për operatorët ekonomikë, si persona fizikë ose juridikë apo atyre në cilësinë e organizatave jofitimprurëse, si dhe për bashkimet e tyre.

6. Përjashtohen nga zbatimi i këtij vendimi grantet dhe projektet për kulturën.

7. Për çdo fazë të procesit, që nuk gjen rregullim konkret në këtë vendim, zbatohen parashikimet e LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik.

8. Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik, sipas parashikimeve të LPP-së, zbatohen edhe për prokurimet në kategoritë e shërbimeve sociale dhe të shërbimeve të tjera specifike.

Neni 2

**Njoftimet**

*(ndryshuar togfjalësh në pikën 2 me VKM Nr. 292, datë 15.5.2024)*

1. Autoritetet ose entet kontraktore, që synojnë të japin një kontratë publike për këto lloj shërbimesh, bëjnë të ditur qëllimin e tyre, nëpërmjet njërës prej mënyrave të mëposhtme:

a) Nëpërmjet njoftimit të kontratës

Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm që u jep mundësi kandidatëve të interesuar të përgatisin ofertat e tyre. Ky njoftim përmban të paktën:

i. emrin dhe adresën e autoritetit ose të entit kontraktor;

ii. emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për procedurën;

iii. objektin e procedurës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);

iv. llojin e procedurës së prokurimit;

v. vlerën limit të përlogaritur të kontratës dhe burimin e financimit;

vi. kohëzgjatjen e kontratës;

vii. një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotit, nëse përdoren;

viii. kushtet për pjesëmarrje;

---

<sup>2</sup> Vendimi nr. 292, datë 15.5.2024, botuar në FZ nr. 84, datë 17.5.2024 në Kreun II të tij shprehet se: "II. Procedurat e prokurimit publik të nisura me kushtje monetare para hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të vijnë në zbatim sipas kushtjeve monetare në fuqi në momentin e fillimit të tyre."

- ix. kriteret e shpalljes së fituesit;
  - x. vendin, datën e orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;
  - xi. gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
  - xii. informacionin, nëse është përdorur njoftim paraprak/periodik i informacionit;
  - xiii. informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti ose enti kontraktor.
- b) Njëpërmjet njoftimit paraprak të informacionit ose të njoftimit periodik të informacionit, i cili u referohet në mënyrë specifike llojeve të shërbimeve që do të jenë objekt i kontratave që do të jepen.

Në rastin kur autoritetet ose entet kontraktore vlerësojnë të përdorin njoftim paraprak/periodik, ftojnë operatorët ekonomikë të interesuar që të shprehin interesin e tyre dhe të përcaktojnë në këtë njoftim që kontratat do të jepen pa shpallje të mëtejshme.

Njoftimi përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, i cili u jep mundësi operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre.

Njoftimi shpallet 35 (tridhjetë e pesë) ditë deri në 18 (tetëmbëdhjetë) muaj përpara datës, në të cilën është dërguar ftesa.

c) Njëpërmjet një njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, i cili shpallet vazhdimisht. Ky njoftim përmban të paktën:

- i. emrin e adresën e entit kontraktor;
- ii. emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës të prokurimit;
- iii. qëllimin e sistemit të kualifikimit;
- iv. objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të prokurimit (CPV);
- v. llojin e kontratës ose kategori sipas llojit të kontratës, kur ka një ndarje të tillë;
- vi. llojin e procedurës së prokurimit që enti kontraktor planifikon të përdorë për dhënien e kontratave;
- vii. periudhën e vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit;
- viii. kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë;
- ix. kriteret për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga sistemi i kualifikimit;
- x. kriteret për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë të tjerë dhe përditësimin periodik të kualifikimeve;
- xi. informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga enti kontraktor.

2. Në njoftimin e kryer, sipas pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor përcakton mundësinë për kontratën e rezervuar për organizata të caktuara, sipas parashikimeve në nenin 103, të LPP-së, ose sipas parashikimeve të nenit 15, të LPP-së.

3. Detyrimi për publikimin e njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk zbatohet kur autoriteti ose enti kontraktor për dhënien e një kontrate publike për shërbime, objekt i këtij vendimi, ndodhet në një nga kushtet e përcaktuara në nenin 47 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor do të ndjekë procedurat e nenit 47 të LPP-së.

### Neni 3

#### **Kontrata të rezervuara për shërbime të caktuara**

*(ndryshuar shkronja ç) e pikës 2 me VKM Nr. 292, datë 15.5.2024)*

1. Autoritetet ose entet kontraktore u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik organizatave të caktuara për dhënien e kontratave publike për shërbime të veçanta, veçanërisht për shërbime shëndetësore, sociale dhe kulturore, sipas shtojcës 2 të këtij vendimi.

2. Organizata, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të plotësojë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) qëllimi i saj të jetë përmbushja e një misioni të shërbimit publik, që lidhet me ofrimin e shërbimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni;

b) përfitimet e krijuara të investohen sërish për përmbushjen e objektivave të organizatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) strukturat drejtuese ose të pronësisë së organizatës bazohen në parimet e pronësisë dhe të pjesëmarrjes së punonjësve ose kërkojnë pjesëmarrje aktive të punonjësve, përdoruesve ose palëve të interesuara; dhe

ç) gjatë tri viteve të fundit, organizata nuk është shpallur fituese e një kontrate për të njëjtat shërbime të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, që prokuron kontratën.

3. Kohëzgjatja e kontratës së lidhur sipas këtij neni nuk mund të jetë më shumë se 3 (tre) vjet.

#### Neni 4

### **Organizimi i procesit**

1. Në rast identifikimi të nevojave për shërbime, objekt i këtij vendimi, titullari i autoritetit ose entit kontraktor apo personi i autorizuar ngarkon njësinë e prokurimit ose struktura të posaçme për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit të procedurës. Në përllogaritjen e fondit limit, zbatohen parashikimet e LPP-së dhe të rregullave të prokurimit publik. Në vijim, titullari i autoritetit ose entit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, ku përcaktohet objekti i prokurimit, vlera e përllogaritur e kontratës dhe autorizohet njësia e prokurimit për vijimin e procesit.

2. Titullari i autoritetit ose entit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdher për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, siç përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

3. Në çdo rast, anëtarët e njësisë së prokurimit, komisionit të vlerësimit të ofertave apo struktura të ngarkuara gjatë kryerjes së procesit të prokurimit, duhet të mbajnë në konsideratë respektimin e rregullave që lidhen me shmangjen e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve në LPP. Për këtë qëllim, duhet të deklarojnë për gjendjen e konfliktit të interesit në momentin e emërimit në këtë cilësi. Gjithashtu, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë detyrim të deklarojnë për gjendjen e konfliktit të interesit edhe me ofertuesit, në momentin e hapjes së ofertave.

#### Neni 5

### **Kufijtë monetarë**

*(ndryshuar pika 1; shtuar fjali në pikën 2 me VKM Nr. 292, datë 15.5.2024)*

1. Kufijtë monetarë për kontratat e shërbimeve ndahen në:

a) kufiri monetar për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike në sektorin klasik;

b) kufiri monetar për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike në kontratat sektoriale.

Vlera e kufijve monetarë përcaktohet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

2. Për shërbimet, objekt i këtij vendimi, vlera e përllogaritur e të cilave brenda një viti kalendarik nuk është më e madhe se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, autoriteti ose enti kontraktor nuk u nënshtrohet procedurave të prokurimit.

Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor detyrohet që në dhënien e kontratave të respektojë parimet e përzgjedhjes të parashikuara në nenin 1 të këtij vendimi. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre shërbimeve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik.

#### Neni 6

### **Procedura e përzgjedhjes**

1. Në përzgjedhjen e fituesve të kontratave për shërbimet, objekt i këtij vendimi, autoritetet ose entet kontraktore përdorin procedurën e hapur për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, e cila lejon mundësinë e pjesëmarrjes së të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar.

2. Procedura e prokurimit për shërbimet, objekt i këtij vendimi, zhvillohet me mjete elektronike në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sipas udhëzimeve të APP-së.

## Neni 7

### **Dokumentet e procedurës**

1. Autoriteti ose enti kontraktor përdor dokumentet standarde të prokurimit të shërbimeve sociale dhe të shërbimeve të tjera specifike, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.
2. Njësia e prokurimit përgatit dokumentet e procedurës konkrete, të cilat duhet të japin gjithë informacionin e nevojshëm për operatorët ekonomikë, në përgatitjen e ofertave të tyre.
3. Dokumentet e procedurës përfshijnë të paktën:
  - a) njoftimin e kontratës;
  - b) njoftimin paraprak të informacionit/njoftimin periodik të informacionit;
  - c) njoftimin për ekzistencën e sistemit të kualifikimit;
  - ç) formularin e kriterëve të pranimit;
  - d) kriteret e përzgjedhjes;
  - dh) termat e referencës për shërbimin;
  - e) afatin e ekzekutimit e çdo të dhënë tjetër që përshkruan kërkesat e objektit të prokurimit dhe vlerësohet e nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës;
  - ë) formularin përmbledhës të deklaramentit;
  - f) njoftimin e fituesit;
  - g) njoftimin e fituesit në përfundim të afateve të ankimit;
  - gj) formularin e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;
  - h) formularin e dërgimit të kundërshtimeve nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;
  - i) formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar;
  - j) formularin e anulimit.

## Neni 8

### **Kriteret e pranimit**

1. Në hartimin e kriterëve të pranimit për shërbimet, objekt i këtij vendimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të sigurojnë që ofertuesit të mos jenë në kushtet e skualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
2. Autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë të vendosë edhe kriteret e veçanta pranimi, në varësi të objektit që prokurohet, nëse vlerëson se këto kriteret janë të domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës. Në çdo rast, këto kriteret duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura me natyrën e përmasat e objektit që prokurohet.
3. Në procedurat e prokurimit për kategoritë e shërbimeve sociale dhe të shërbimeve të tjera specifike, autoriteti ose enti kontraktor nuk kërkon paraqitjen e sigurimit të ofertës.

## Neni 9

### **Kriteret e përzgjedhjes**

1. Autoritetet ose entet kontraktore parashikojnë që zgjedhja e ofruesit të shërbimit të bëhet mbi bazën e ofertës që paraqet raportin më të mirë çmim-cilësi, duke marrë në konsideratë kriteret e cilësisë dhe qëndrueshmërisë për shërbimet sociale.
2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, në përputhje me nenet 87 e 88, të LPP-së, dhe vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë, sipas rastit, cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale dhe natyrën e veçantë të këtyre shërbimeve.
3. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë, ku çmimi do të

vlerësohet jo më pak se 20 pikë.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter e, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula, me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve, përcaktohet në dokumentet standarde të prokurimit të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike.

#### Neni 10

### **Shpallja e procedurës**

1. Autoriteti ose enti kontraktor shpall një njoftim, sipas nenit 3 të këtij vendimi, i cili publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

2. Afati kohor për dorëzimin e ofertave përcaktohet nga autoriteti ose enti kontraktor, në varësi të kompleksitetit të shërbimit që prokurohet dhe kohës së nevojshme që mund t'u duhet kandidatëve në përgatitjen e ofertave të tyre. Në çdo rast, afati minimal do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat mbi kufirin monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin monetar.

#### Neni 11

### **Shqyrtimi i ofertave**

1. Operatorët ekonomikë të interesuar paraqesin ofertën dhe dokumentet e kërkuara nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e kontratës, për të provuar se zotërojnë kapacitetet ligjore, ekonomike, teknike e profesionale. Plotësimi i kriterëve të pranimit bëhet sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik.

2. Autoriteti ose enti kontraktor shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë në bazë të kriterëve për kualifikim jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e hapjes së procedurës për procedurat mbi kufirin monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin monetar.

3. Nëse dy ose më shumë oferta kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.

4. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët, si dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike bëhet sipas parashikimeve të rregullave të prokurimit publik.

#### Neni 12

### **Njoftimi i fituesit**

Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga përfundimi i procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në Sistemin e Prokurimit Elektronik njoftimin e fituesit të procedurës.

#### Neni 13

### **Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit, sipas parashikimeve të LPP-së dhe të rregullave të prokurimit publik.

2. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e vendimit për anulimin e procedurës, autoriteti ose enti kontraktor dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në Sistemin e Prokurimit Elektronik njoftimin e anulimit të procedurës.

#### Neni 14

## Ankimi

Rregullat e parashikuara në LPP dhe rregullat e prokurimit publik për paraqitjen e shqyrtimin e ankesave do të zbatohen edhe për procedurën e prokurimit, për shërbimet objekt i këtij vendimi.

Neni 15

### Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Autoritetet ose entet kontraktore, që kanë dhënë një kontratë publike për kategoritë e shërbimeve, objekt i këtij vendimi, publikojnë një njoftim për dhënien e kontratës, sipas përcaktimit në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik.

#### SHTOJCA 1 SHËRBIMET SOCIALE DHE SHËRBIMET E TJERA SPECIFIKE

Përshkrimi	Kodi CPV	Sqarime
Shërbime shëndetësore, sociale dhe shërbime të lidhura me to	75200000-8 [Ofrimi i shërbimeve ndaj komunitetit]	
	75231200-6 [Shërbimet në lidhje me ndalimin ose rehabilitimin e kriminelëve]	
	75231240-8 [Shërbimet e lirit me kusht]	
	79611000-0 [Shërbime të kërkimit të punës]	
	79622000-0 [Shërbime të furnizimit të personelit ndihmës në shtëpi]	
	79624000-4 [Shërbime të furnizimit të personelit të infermierisë]	
	79625000-1 [Shërbime të furnizimit të personelit mjekësor]	
	85000000-9 [Shërbime shëndetësore dhe shërbime të punës sociale]	
	85100000-0 [Shërbime shëndetësore]	Të gjitha shërbimet që janë të përfshira në grupin e kodeve ku tri shifrat e para janë 851 – u përkasin llojeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi për shërbimet e kujdesit shëndetësor, të cilat në vijim detajohen (në klasa, kategori etj.) sipas tipologjisë së shërbimeve shëndetësore.
	85110000-3 [Shërbime spitalore dhe shërbime të lidhura me to]	
	85111000-0 [Shërbime spitalore]	
	85111100-1 [Shërbime spitalore kirurgjikale]	

85111200-2 [Shërbimet spitalore mjekësore]	
85111300-3 [Shërbime spitalore gjinekologjike]	
85111310-6 [Shërbime fertilizimi artificial]	
85111320-9 [Shërbime spitalore obstetrike]	
85111400-4 [Shërbimet spitalore rehabilitimi]	
85111500-5 [Shërbimet spitalore psikiatrike]	
85111600-6 [Shërbime ortopedike]	
85111700-7 [Shërbime terapie oksigjenike]	
85111800-8 [Shërbime patologjike]	
85111810-1 [Shërbime të analizave të gjakut]	
85111820-4 [Shërbime të analizave bakteriologjike]	
85111900-9 [Shërbime dializash spitalore]	
85112000-7 [Shërbime mbështetëse spitalore]	
85112100-8 [Shërbime për furnizimin e lavanderisë së spitalit]	
85112200-9 [Shërbime të kujdesit ambulator]	
85120000-6 [Praktika mjekësore dhe shërbime të lidhura me to]	
85121000-3 [Shërbime praktikash mjekësore]	
85121100-4 [Shërbime nga mjekë të përgjithshëm]	
85121200-5 [Shërbime të specializuara mjekësore]	
85121210-8 [Shërbime gjinekologjike ose obstetrike]	
85121220-1 [Shërbime të specializuara të sistemit nervor ose nefrologjik]	
85121230-4 [Shërbime kardiologjike ose shërbime të specializuara pulmonare]	
85121231-1 [Shërbime kardiologjike]	
85121232-8 [Shërbime të specializuara pulmonare]	
85121240-7 [Shërbime otologjike dhe	

ORL]	
85121250-0 [Shërbime gastroenterologjike dhe geriatrike]	
85121251-7 [Shërbime gastroenterologjike]	
85121252-4 [Shërbime geriatrike]	
85121270-6 [Shërbime psikiatrike ose psikologjike]	
85121271-3 [Shërbime institucionesh për njerëzit me çrregullime psikologjike]	
85121280-9 [Shërbime oftamologjike, dermatologjike ose ortopedike]	
85121281-6 [Shërbime oftamologjike]	
85121282-3 [Shërbimet dermatologjike]	
85121283-0 [Shërbimet ortopedike]	
85121290-2 [Shërbime pediatrike apo urologjike]	
85121291-9 [Shërbime pediatrike]	
85121292-6 [Shërbimet urologjike]	
85121300-6 [Shërbime kirurgjikale të specializuara]	
85130000-9 [Praktika dentare dhe shërbime të lidhura me to]	
85131000-6 [Shërbime praktikash dentare]	
85131100-7 [Shërbime ortodontike]	
85131110-0 [Shërbime kirurgjikale ortodontike]	
85140000-2 [Shërbimet të ndryshme shëndetësore]	
85141000-9 [Shërbime të ofruara nga personeli mjekësor]	
85141100-0 [Shërbime të ofruara nga mami]	
85141200-1 [Shërbime të ofruara nga infermierët]	
85141210-4 [Shërbime të trajtimit mjekësor në shtëpi]	
85141211-1 [Shërbime të trajtimit mjekësor në raste dialize në shtëpi]	
85141220-7 [Shërbime këshilluese të ofruara nga infermieret]	
85142000-6 [Shërbime ambulatorë]	
85142100-7 [Shërbime fizioterapie]	
85142200-8 [Shërbime homeopatike]	
85142300-9 [Shërbime të higjienës]	

85142400-0 [Dërgimi në shtëpi i produkteve për inkonteniençën]	
85143000-3 [Shërbime ambulance]	
85144000-0 [Shërbime për shtëpitë e të moshuarve]	
85144100-1 [Shërbime të kujdesit infermieror për shtëpitë e të moshuarve]	
85145000-7 [Shërbime të ofruara nga laboratorët mjekësorë]	
85146000-4 [Shërbime të ofruara nga bankat e gjakut]	
85146100-5 [Shërbime të ofruara nga bankat e spermës]	
85146200-6 [Shërbime të ofruara nga bankat e transplantit të organeve]	
85147000-1 [Shërbime shëndetësore për kompani]	
85148000-8 [Shërbime analizash mjekësore]	
85149000-5 [Shërbime farmaceutike]	
85150000-5 [Shërbime mjekësore të imazherisë]	
85160000-8 [Shërbime të optikës]	
85170000-1 [Shërbime akupunture dhe fizioterapie]	
85171000-8 [Shërbime akupunture]	
85172000-5 [Shërbime fizioterapie]	
85200000-1 [Shërbime veterinarie]	
85210000-3 [Shërbime veterinarie në shtëpi]	
85300000-2 [Shërbime të punës sociale dhe të lidhura me to]	Të gjitha shërbimet që janë të përfshira në grupin e kodeve ku katër shifrat e para janë 8531 – u përkasin llojeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në kuptim të legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit social (ligji 121/2016 dhe VKM-së 518/2018).
85310000-5 [Shërbime të punës sociale]	
85311000-2 [Shërbimet për punë sociale me strehim]	Grupi i kodeve me shifrat e para 85311 u përkasin tipologjive të shërbimeve rezidenciale.
85311100-3 [Shërbime të mirëqenies për të moshuarit]	
853112004 [Shërbime të mirëqenies për invalidë]	

85311300-5 [Shërbime të mirëqenies për fëmijët dhe të rinjtë]	
85312000-9 [Shërbime për punë sociale pa akomodim]	Grupi i kodeve me shifrat e para 85312 i përkasin tipologjive të shërbimeve ditore.
85312100-0 [Shërbime ditore]	
85312110-3 [Shërbime për kujdesin e fëmijëve]	
85312120-6 [Shërbime ditore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara]	
85312200-1 [Ofrimi në shtëpi i ushqimit]	
85312300-2 [Shërbime të udhëzimit dhe këshillimit]	
85312310-5 [Shërbimet udhëzimi]	Shërbimet parashoqërore informim dhe këshillim.
85312320-8 [Shërbime të këshillimit]	
85312330-1 [Shërbime të planifikimit familjar]	
85312400-3 [Shërbime të mirëqenies të paofruara përmes institucioneve rezidenciale]	
85312500-4 [Shërbime të rehabilitimit]	Të gjitha llojet e shërbimeve rehabilituese shëndetësore dhe sociale.
85312510-7 [Shërbime të rehabilitimit profesional]	Shërbime rehabilituese okupacionale.
85320000-8 [Shërbime sociale]	
85321000-5 [Shërbime administrative sociale]	Këto konsiderohen shërbime të tjera specifike të kujdesit social.
85322000-2 [Programi i veprimit komunal]	
85323000-9 [Shërbimet shëndetësore të komunitetit]	
98133100-5 [Shërbime të ofruara nga qytetarë dhe objekte komunale]	
98133000-4 [Shërbime të ofruara nga organizatat me karakter social]	
98200000-5 [Shërbime të konsulencës në fushën e mundësive të barabarta]	
98500000-8 [Njësi ekonomike familjare private me persona të punësuar]	
98513000-2 [Shërbime të fuqisë punëtore për familjet]	
98513100-3 [Shërbimet të stafit të agjencisë për familjet]	
98513200-4 [Shërbime të stafit klerik]	

	për familjet]	
	98513300-5 [Stafi i përkohshëm për familjet]	
	98513310-8 [Shërbime të kujdesit në familje]	Shërbimi “asistenca në familje”.
	98514000-9 [Shërbime të brendshme]	
Shërbime administrative, sociale, arsimore, shëndetësore dhe kulturore	85321000-5 [Shërbime administrative sociale]	
	85322000-2 [Programi i veprimit komunal]	
	75000000-6 [Shërbime në fushën e administratës, mbrojtjes dhe sigurimeve shoqërore]	
	75121000-0 [Shërbimet administrative arsimore]	
	75122000-7 [Shërbimet administrative të kujdesit shëndetësor]	
	75124000-1 [Shërbimet administrative rekreative të kujdesit shëndetësor]	
	79995000-5 [Shërbime për menaxhimin e bibliotekës]	
	79995100-6 [Shërbime të arkivimit]	
	79995200-7 [Shërbime regjistrimi]	
	80000000-4 [Shërbime edukimi dhe trajnimi]	
	80100000-5 [Shërbime të arsimit fillor]	
	80110000-8 [Shërbime të arsimit parashkollor]	
	80200000-6 [Shërbime të arsimit të mesëm]	
	80210000-9 [Shërbime teknike dhe profesionale të arsimit të mesëm]	
	80211000-6 [Shërbime teknike të arsimit të mesëm]	
	80212000-3 [Shërbime profesionale të arsimit të mesëm]	
	80300000-7 [Shërbime të arsimit të lartë]	
	80310000-0 [Shërbime të edukimit të rinjve]	
	80320000-3 [Shërbime të edukimit mjekësor]	
	80330000-6 [Shërbime të edukimit të sigurisë]	
80340000-9 [Shërbime të veçanta të edukimit]		

80400000-8 [Shërbime të edukimit për të rriturit dhe shërbime të tjera edukimi]	
80410000-1 [Shërbime të ndryshme shkollore]	
80411000-8 [Shërbime të ngjarjes me automjet për në shkollë]	
80411100-9 [Shërbime për provimin e patentës]	
80411200-0 [Leksione për përdorimin e makinës]	
80412000-5 [Shërbime shkollore për pilotim]	
80413000-2 [Shërbime shkollore për lundrim]	
80414000-9 [Shërbime shkollore për zhytje]	
80415000-6 [Shërbime trajnimi për ski]	
80420000-4 [Shërbime e-Learning]	
80430000-7 [Shërbime universitare për të rriturit]	
80490000-5 [Menaxhimi i një qendre trajnimi]	
80500000-9 [Shërbime të trajnimit]	
80510000-2 [Shërbime trajnimi të specializuara]	
80511000-9 [Shërbime të trajnimit të stafit]	
80512000-6 [Shërbime të trajnimit për qentë]	
80513000-3 [Shërbime shkollore për kalërim]	
80520000-5 [Pajisjet e trajnimit]	
80521000-2 [Shërbime për programe trajnimi]	
80522000-9 [Seminare trajnimi]	
80530000-8 [Shërbime të formimit profesional]	
80531000-5 [Shërbime të trajnimit teknik dhe industrial]	
80531100-6 [Shërbime të trajnimit industrial]	
80531200-7 [Shërbime të trajnimit teknik]	
80532000-2 [Shërbime të trajnimit të menaxhimit]	
80533000-9 [Shërbimet e njohjes dhe	

	trajnimet për përdoruesit e kompjuterave]	
	80533100-0 [Shërbime trajnimi kompjuterik]	
	80533200-1 [Kurse kompjuterike]	
	80540000-1 [Shërbime trajnimi mjedisor]	
	80550000-4 [Shërbime trajnimi në fushën e sigurisë]	
	80560000-7 [Shërbime shëndetësore dhe shërbime trajnimi për ndihmën e parë]	
	80561000-4 [Shërbime trajnimi shëndetësor]	
	80562000-1 [Shërbime trajnimi të ndihmës së parë]	
	80570000-0 [Shërbime trajnimi të zhvillimit personal]	
	80580000-3 [Ofrimi i kurseve të gjuhës]	
	80590000-6 [Shërbime tutorial]	
	80600000-0 [Shërbime trajnimi në mbrojtjen dhe sigurinë e materialeve]	
	80610000-3 [Trajnim dhe simulim në pajisjet e sigurisë]	
	80620000-6 [Trajnim dhe simulim në armët e zjarrit dhe municionit]	
	80630000-9 [Trajnim dhe simulim në automjetet ushtarake]	
	80640000-2 [Trajnim dhe simulim në anijet e luftës]	
	80650000-5 [Trajnim dhe simulim në aeroplanët, raketat dhe anijet hapësinore]	
	80660000-8 [Trajnim dhe simulim në sistemet ushtarake elektronike]	
	92000000-1 [Shërbime çlodhëse, kulturore dhe sportive]	
	92110000-5 [Shërbime të lidhura me prodhimin e filmave dhe videove dhe shërbime të tjera]	
	92111000-2 [Shërbime të prodhimit të filmave dhe videove]	
	92111100-3 [Prodhimi i filmit dhe videokasetës për trajnim]	
	92111200-4 [Prodhimi i filmit dhe videokasetës për reklame, propagandë dhe informacion]	

	92111210-7 [Prodhimi i videokasetës për reklamë]	
	92111220-0 [Prodhimi i videokasetës për reklamë]	
	92111230-3 [Prodhimi i filmit propagandistik]	
	92111240-6 [Prodhimi i videokasetës propagandistike]	
	92111250-9 [Prodhimi i filmit për informacion]	
	92111260-2 [Prodhimi i videokasetës për informacion]	
	92111300-5 [Prodhimi i filmit dhe videokasetës për argëtim]	
	92111310-8 [Prodhimi i filmit për argëtim]	
	92111320-1 [Prodhimi i videokasetës për argëtim]	
	92112000-9 [Shërbime të lidhura me prodhimin e filmit dhe videokasetës]	
	92120000-8 [Shërbime të shpërndarjes së filmit dhe videokasetës]	
	92121000-5 [Shërbime të shpërndarjes së videokasetës]	
	92130000-1 [Shërbime projektimi kinematografie]	
	92140000-4 [Shërbime të projektimit të videokasetave]	
	92200000-3 [Shërbime radio dhe shërbime televizive]	
	92210000-6 [Shërbime radio]	
	92211000-3 [Shërbime të prodhimit radio]	
	92213000-7 [Shërbime të sistemeve të vogla radio]	
	92214000-4 [Shërbime studioje ose pajisje radio]	
	92215000-1 [Shërbime radiomobile të përgjithshme (shrpm)]	
	92216000-8 [Shërbime radiofamiljare (shrf)]	
	92217000-5 [Shërbime radiomobile të përgjithshme/ Shërbime radiofamiljare (shrpm/shrf)]	
	92220000-9 [Shërbime televizive]	
	92221000-6 [Shërbime të prodhimit televiziv]	

92222000-3 [Shërbime televizive me qark të mbyllur]	
92224000-7 [Televizion digjital]	
92225000-4 [Televizion interaktiv]	
92225100-7 [Televizion me filma “On-demand”]	
92226000-1 [Programacioni i televizorit]	
92230000-2 [Shërbimet kabllore televizive dhe radio]	
92231000-9 [Shërbime ndërkombëtare bilaterale dhe linjat private ndërkombëtare me qira]	
92232000-6 [TV kabllor]	
92300000-4 [Shërbime argëtimi]	
92312211-3 [Shërbime te agjencie shkruese]	
92312212-0 [Shërbime që lidhen me përgatitjen e manualëve të trajnimit]	
92312213-7 [Shërbime të autorëve teknik]	
92312220-9 [Shërbime të ofruara nga kompozitorë]	
92312251-5 [Shërbime të <i>deejay</i> -ve]	
92320000-0 [Shërbime të menaxhimit të infrastrukturës artistike]	
92330000-3 [Shërbime të zonave rekreative]	
92331000-0 [Shërbime parqesh argëtuese dhe luna park]	
92331100-1 [Shërbime luna park]	
92331200-2 [Shërbime parqesh argëtuese]	
92331210-5 [Shërbime animacioni për fëmijët]	
92332000-7 [Shërbime plazhi]	
92340000-6 [Shërbime valleje dhe argëtimi]	
92341000-3 [Shërbime cirku]	
92342000-0 [Shërbime kurse kërcimi]	
92342100-1 [Shërbime kurse vallëzimi për shoqërinë]	
92342200-2 [Shërbime kurse vallëzimi për në disko]	
92350000-9 [Shërbime në lidhje me lojërat e fatit dhe bastet]	
92351000-6 [Shërbimet në lidhje me lojërat e fatit]	

92351100-7 [Shërbimet të menaxhimit të lotarisë]	
92351200-8 [Shërbimet për menaxhimin e kazinove]	
92352000-3 [Shërbimet e basteve]	
92352100-4 [Shërbimet për menaxhimin e makinerive të basteve]	
92352200-5 [Shërbime <i>bookmaking</i> ]	
92360000-2 [Shërbime piroteknike]	
92370000-5 [Teknik zëri]	
92400000-5 [Shërbimet e agjencive të lajmeve]	
92500000-6 [Shërbime bibliotekare, arkivave, muzeve dhe shërbime të tjera kulturore]	
92510000-9 [Shërbime bibliotekare dhe arkivore]	
92511000-6 [Shërbime bibliotekare]	
92512000-3 [Shërbime arkivore]	
92512100-4 [Shërbime të shkatërrimit të arkivave]	
92520000-2 [Shërbimet muzeu dhe për ruajtjen e vendeve historike dhe të ndërtesave]	
92521000-9 [Shërbime muzeu]	
92521100-0 [Shërbime ekspozite ne muze]	
92521200-1 [Shërbime për ruajtjen e ekspozitave dhe mostrave]	
92521210-4 [Shërbimet për ruajtjen e ekspozitave]	
92521220-7 [Shërbimet për ruajtjen e mostrave]	
92522000-6 [Shërbime për ruajtjen e vendeve historike dhe të ndërtesave]	
92522100-7 [Shërbime për ruajtjen e vendeve historike]	
92522200-8 [Shërbime për ruajtjen e ndërtesave historike]	
92530000-5 [Shërbime për kopshte botanike, kopshte zoologjike dhe rezervat natyrore]	
92531000-2 [Shërbime për kopshte botanike]	
92532000-9 [Shërbime për kopshte zoologjike]	
92533000-6 [Shërbime për rezervat e natyrës]	

	92534000-3 [Shërbime për mbrojtje nga kafshët e egra]	
	92600000-7 [Shërbime sportive]	
	92610000-0 [Shërbime për menaxhimin e objekteve sportive]	
	92620000-3 [Shërbime të lidhura me sportin]	
	92621000-0 [Shërbime për promovimin e ngjarjeve sportive]	
	92622000-7 [Shërbime organizimi të ngjarjeve sportive]	
	92700000-8 [Shërbime <i>cybercafé</i> ]	
	79951000-5 [Shërbime për organizim seminari]	
	79952000-2 [Shërbime aktivitete]	
	79952100-3 [Shërbime për organizim aktiviteti kulturor]	
	79954000-6 [Shërbime për organizim feste]	
	79955000-3 [Shërbime për organizim të shfaqjeve të modës]	
	79956000-0 [Shërbime për organizim panairi dhe ekspozite]	
Shërbime të sigurimeve shoqërore të detyrueshme	75300000-9 [ Shërbimet e detyrueshme të sigurisë sociale]	
Shërbime përfitimi	75310000-2 [Shërbimet e sigurimeve]	
	75311000-9 [Përfitimet e sëmundjeve]	
	75312000-6 [Përfitimet e lindjes]	
	75313000-3 [Përfitimet për aftësinë e kufizuar]	
	75313100-4 [Përfitimet e përkohshme për aftësinë e kufizuar]	
	75314000-0 [Përfitimet e kompensimit të papunësisë]	
	75320000-5 [Skemat e pensioneve të punonjësve të qeverisë]	
	75330000-8 [Ndihmat financiare familjare]	
	75340000-1 [Ndihma financiare për fëmijë]	
Shërbime të tjera komunitare, sociale dhe personale, duke përfshirë shërbimet e ofruara nga	98000000-3 [Shërbime të tjera të komunitetit, sociale dhe shërbime personale]	
	98120000-0 [Shërbime të ofruara nga sindikatat]	

sindikatat, organizatat politike, shoqatat rinore dhe shërbime të tjera për anëtarë të organizatave	98132000-7 [Shërbime të ofruara nga organizatat politike]	
	98133110-8 [Shërbime të ofruara nga shoqata rinore]	
	98130000-3 [Shërbime të ndryshme nga organizatat e anëtarësimit]	
Shërbime fetare	98131000-0 [Shërbime fetare]	
Shërbimet e hotelerisë dhe restoranteve	55100000-1 [Shërbime hotelerie]	
	55110000-4 [Shërbime të akomodimit në hotele]	
	55120000-7 [Shërbime hotelerie për takime dhe konferenca]	
	55130000-0 [Shërbime të tjera hotelerie]	
	55200000-2 [Kampingje dhe strehime të tjera jo-hotelerie]	
	55210000-5 [Shërbime hostel për të rinjtë]	
	55220000-8 [Shërbime për akomodimin në kampingje]	
	55221000-5 [Shërbime për akomodimin në zonat për rulota]	
	55240000-4 [Shërbime në qendrat dhe shtëpitë e pushimit]	
	55241000-1 [Shërbime në qendrat e pushimit]	
	55242000-8 [Shërbime në shtëpitë e pushimit]	
	55243000-5 [Shërbime në kampet e pushimit për fëmijë]	
	55250000-7 [Shërbime për dhënie me qira dhe akomodimin për kohë të shkurtër]	
	55260000-0 [Shërbime vagonash me shtrat]	
	55270000-3 [Shërbime të ofruara nga pensionet]	
	55300000-3 [Shërbime restorant dhe shpërndarje ushqimesh]	
	55310000-6 [Shërbime restorantesh me kamarierë]	
	55311000-3 [Shërbime restoranti me kamarier për klientelë të kufizuar]	
	55312000-0 [Shërbime restoranti me kamarier për klientele të pakufizuar]	
	55320000-9 [Shërbime për shpërndarjen e vakteve]	
55321000-6 [Shërbime për gatimin e		

	vakteve]	
	55322000-3 [Shërbime për përgatitjen e vakteve]	
	55330000-2 [Shërbime kafeterie]	
	55400000-4 [Shërbime për shpërndarjen e pijeve]	
	55410000-7 [Shërbime për menaxhimin e bareve]	
	55521000-8 [Shërbimet katering për ekonomitë familjare private]	
	55521100-9 [Shërbime për dërgimin e vakteve në shtëpi]	
	55521200-0 [Shërbime për dërgimin e vakteve]	
	55521000-8 [Shërbime katering për shtëpi private]	
	55521100-9 [Shërbimet e ushqimit në kioska]	
	55521200-0 [Shërbimi i shpërndarjes së ushqimit]	
	55520000-1 [Shërbime katering]	
	55522000-5 [Shërbime katering për ndërmarrje transporti]	
	55523000-2 [Shërbime katering për ndërmarrje të tjera ose institucione të tjera]	
	55524000-9 [Shërbime katering në shkollë]	
	55510000-8 [Shërbime në mensë]	
	55511000-5 [Shërbime në mensë ose kafene të tjera me klientelë të kufizuar]	
	55512000-2 [Shërbime të menaxhimit të mensës]	
	55523100-3 [Shërbime të ushqimit në shkollë]	
Shërbime ligjore, deri në masën që nuk përjashtohen sipas nenit 7, pika 1, shkronja "d", të LPP	79100000-5 [Shërbime ligjore]	
	79110000-8 [Shërbime të përfaqësimit dhe konsulencës ligjore]	
	79111000-5 [Shërbime të konsulencës ligjore]	
	79112000-2 [Shërbime të përfaqësimit ligjor]	
	79112100-3 [Shërbime të përfaqësimit të palëve të interesuara]	
	79120000-1 [Shërbime konsulence të patentimit dhe të drejtave të autorit]	
	79121000-8 [Shërbime konsulence të	

	të drejtave të autorit]	
	79121100-9 [Shërbime konsulence të të drejtave të autorit të softwareve]	
	79130000-4 [Shërbime të dokumentimit dhe certifikimit ligjor]	
	79131000-1 [Shërbime të dokumentimit]	
	79132000-8 [Shërbime të certifikimit]	
	79132100-9 [Shërbime të certifikimit të nën shkrimeve elektronike]	
	79140000-7 [Shërbime të konsulencës dhe informacionit ligjor]	
	75231100-5 [Shërbimet administrative të gjykatave]	
Shërbime të tjera administrative dhe shërbime shtetërore	75100000-7 [Shërbimet e administrimit]	
	75110000-0 [Shërbimet e përgjithshme publike]	
	75111000-7 [Shërbimet ekzekutive dhe legjislative]	
	75111100-8 [Shërbimet ekzekutive]	
	75111200-9 [Shërbimet legjislative]	
	75112000-4 [Shërbimet administrative për operacionet e biznesit]	
	75112100-5 [Shërbimet administrative të zhvillimit të projektit]	
	75120000-3 [Shërbimet administrative të agjencive]	
	75123000-4 [Shërbimet administrative të strehimit]	
	75124000-1 [Shërbimet administrative rekreative, kulturore dhe fetare]	
	75125000-8 [Shërbimet administrative në lidhje me turizmin]	
	75130000-6 [Shërbimet mbështetëse për qeverinë]	
	75131000-3 [Shërbimet qeveritare]	
	Ofrimi i shërbimeve për komunitetin	75200000-8 [Ofrimi i shërbimeve ndaj komunitetit]
75211200-0 [Shërbimet e ndihmës së huaj ekonomike]		
75211300-1 [Shërbimet e ndihmës së huaj ushtarake]		
75220000-4 [Shërbimet e mbrojtjes]		
75221000-1 [Shërbimet e mbrojtjes]		

	ushtarake]		
	75222000-8 [Shërbimet e mbrojtjes civile]		
	75230000-7 [Shërbimet e drejtësisë]		
	75231000-4 [Shërbimet gjyqësore]		
Shërbime që lidhen me burgun, sigurinë publike dhe shërbime shpëtimi	75231210-9 [Shërbimet e burgimit]		
	75231220-2 [Shërbimet e transportimit të të burgosurve]		
	75231230-5 [Shërbimet e burgjeve]		
	75240000-0 [Shërbimet e sigurisë, ligjit dhe rendit publik]		
	75241000-7 [Shërbimet e sigurisë publike]		
	75241100-8 [Shërbimet policore]		
	75242000-4 [Shërbimet e ligjit dhe rendit publik]		
	75242100-5 [Shërbimet e rendit publik]		
	75242110-8 [Shërbimet përmbartimore]		
	75250000-3 [Shërbimet e shpëtimit dhe zjarrfikëses]		
	75251000-0 [Shërbimet e zjarrfikëses]		
	75251100-1 [Shërbimet zjarrfikëse]		
	75251110-4 [Shërbimet e parandalimit të zjarrit]		
	75251120-7 [Shërbimet zjarrfikëse të pyjeve]		
	794300000-7 [Shërbime të menaxhimit të krizave]		
	98113100-9 [Shërbimet e sigurisë bërthamore]		
	Shërbimet hetimore dhe të sigurisë	79700000-1 [Shërbime hetimi dhe sigurie]	
		79710000-4 [Shërbime sigurie]	
		79711000-1 [Shërbime sinjalizimi-monitorimi]	
79713000-5 [Shërbime të ruajtjes]			
79714000-2 [Shërbime mbikëqyrjeje]			
79714100-3 [Shërbime të sistemeve gjurmuese]			
79714110-6 [Shërbime të gjurmimit të të arratisurit]			
79715000-9 [Shërbime patrulle]			
79716000-6 [Shërbime për lëshimin e kartave identifikuese]			
79720000-7 [Shërbime hetimi]			

	79721000-4 [Shërbime të agjencive detektive]	
	79722000-1 [Shërbime grafologjie]	
	79723000-8 [Shërbime të analizimit të mbetjeve]	
Shërbime ndërkombëtare	98900000-2 [Shërbime që ofrohen nga organizata dhe organe ekstraterritoriale]	
	98910000-5 [Shërbime specifike për organizata dhe organe ndërkombëtare]	
Shërbimet postare	64000000-6 [Shërbime postare dhe të telekomunikacionit]	
	64100000-7 [Shërbime poste dhe dërgese]	
	64110000-0 [Shërbime postare]	
	64111000-7 [Shërbime postare të lidhura me gazetat dhe botimet periodike]	
	64112000-4 [Shërbimet postare për letrat]	
	64113000-1 [Shërbimet postare për pakot]	
	64114000-8 [Shërbimet në zyrat postare]	
	64116000-2 [Shërbimet postare të përgjithshme]	
	64115000-5 [Dhënia me qira e kutisë postare]	
	64122000-7 [Shërbime të postës dhe korrierit brenda zyrës]	
Shërbime të ndryshme	50116510-9 [Shërbime për riveshje gome]	
	71550000-8 [Shërbime farkëtarie]	

**SHTOJCA 2**  
**KONTRATA TË REZERVUARA PËR SHËRBIME TË CAKTUARA**

<b>Kodi CPV</b>	<b>Përshkrimi</b>
75121000-0	Shërbimet administrative arsimore
75122000-7	Shërbimet administrative të kujdesit shëndetësor
75123000-4	Shërbimet administrative të strehimit
79622000-0	Shërbime të furnizimit të personelit të brendshëm ndihmës
79624000-4	Shërbime të furnizimit të personelit të infermierisë
79625000-1	Shërbime të furnizimit të personelit mjekësor
80110000-8	Shërbime të arsimit parashkollor
80300000-7	Shërbime të arsimit të lartë
80420000-4	Shërbime <i>e-Learning</i>

80430000-7	Shërbime universitare për të rriturit
80511000-9	Shërbime të trajnimit të stafit
80520000-5	Pajisjet e trajnimit
80590000-6	Shërbime tutorial
85000000-9	Shërbime shëndetësore dhe punë sociale
85100000-0	Shërbime shëndetësore
85110000-3	Shërbime spitalore dhe të lidhura me to
85111000-0	Shërbime spitalore
85111100-1	Shërbime spitalore kirurgjikale
85111200-2	Shërbimet spitalore mjekësore
85111300-3	Shërbime spitalore gjinekologjike
85111310-6	Shërbime fertilizimi artificiale
85111320-9	Shërbime spitalore obstetrike
85111400-4	Shërbimet spitalore rehabilitimi
85111500-5	Shërbimet spitalore psikiatrike
85111600-6	Shërbime ortopedike
85111700-7	Shërbime terapie oksigjenike
85111800-8	Shërbime patologjike
85111810-1	Shërbime të analizave të gjakut
85111820-4	Shërbime të analizave bakteriologjike
85111900-9	Shërbime dializash spitalore
85112000-7	Shërbime mbështetëse spitalore
85112100-8	Shërbime për furnizimin e lavanderisë së spitalit
85112200-9	Shërbime të kujdesit ambulator
85120000-6	Praktika mjekësore dhe shërbime të lidhura me to
85121000-3	Shërbime praktikash mjekësore
85121100-4	Shërbime nga mjekë të përgjithshëm
85121200-5	Shërbime të specializuara mjekësore
85121210-8	Shërbime gjinekologjike ose obstetrike
85121220-1	Shërbime të specializuara të sistemit nervor ose nefrologjik
85121230-4	Shërbime kardiologjike ose shërbime të specializuara pulmonare
85121231-1	Shërbime kardiologjike
85121232-8	Shërbime të specializuara pulmonare
85121240-7	Shërbime audiologjike dhe ORL
85121250-0	Shërbime gastroenterologjike dhe geriatrike
85121251-7	Shërbime gastroenterologjike
85121252-4	Shërbime geriatrike
85121270-6	Shërbime psikiatrike ose psikologjike
85121271-3	Shërbime institucionesh për njerëzit me çrregullime psikologjike
85121280-9	Shërbime oftalmologjike, dermatologjike ose ortopedike
85121281-6	Shërbime okulistike
85121282-3	Shërbimet dermatologjike
85121283-0	Shërbimet ortopedike
85121290-2	Shërbime pediatrike apo urologjike
85121291-9	Shërbime pediatrike
85121292-6	Shërbimet urologjike
85121300-6	Shërbime kirurgjikale të specializuara
85130000-9	Shërbime të lidhura dhe praktika dentare
85131000-6	Shërbime praktikash dentare

85131100-7	Shërbime ortodontike
85131110-0	Shërbime kirurgjikale ortodontike
85140000-2	Shërbimet të ndryshme shëndetësore
85141000-9	Shërbime të ofruara nga personeli mjekësor
85141100-0	Shërbime të ofruara nga mami
85141200-1	Shërbime të ofruara nga infermierët
85141210-4	Shërbime të trajtimit mjekësor në shtëpi
85141211-1	Shërbime të trajtimit mjekësor në raste dialize në shtëpi
85141220-7	Shërbime këshilluese të ofruara nga infermierët
85142000-6	Shërbime ambulatorore
85142100-7	Shërbimet fizioterapie
85142200-8	Shërbimet homeopatike
85142300-9	Shërbime të higjienës
85142400-0	Ofrimi në shtëpi i produkteve për inkontinencën
85143000-3	Shërbime ambulance
85144000-0	Shërbime për shtëpitë e të moshuarve
85144100-1	Shërbime të kujdesit infermieror për shtëpitë e të moshuarve
85145000-7	Shërbime të ofruara nga laboratorët mjekësore
85146000-4	Shërbime të ofruara nga bankat e gjakut
85146100-5	Shërbime të ofruara nga bankat e spermës
85146200-6	Shërbime të ofruara nga bankat e transplantit të organeve
85147000-1	Shërbime shëndetësore për kompani
85148000-8	Shërbime analizash mjekësore
85149000-5	Shërbime farmaceutike
85150000-5	Shërbime mjekësore të imazherisë
85160000-8	Shërbime optike
85170000-1	Shërbime akupunktore dhe fizioterapie
85171000-8	Shërbime akupunktore
85172000-5	Shërbime fizioterapie
85200000-1	Shërbime veterinarie
85210000-3	Shërbime veterinarie në shtëpi
85300000-2	Shërbime të punës sociale dhe të lidhura
85310000-5	Shërbime të punës sociale
85311000-2	Shërbime për punë sociale me strehim
85311100-3	Shërbime të mirëqenies për të moshuarit